



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.899/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues Adnan Konushevi dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Shkelzen Spahiu, kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.899/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Shkelzen Spahiu, kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.899/2021 të paraqitur nga Shkelzen Spahiu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, me të cilën pretendon se sipas Rezultateve Përfundimtare të KQZ-së, ka mos përputhje të rezultatit të votave nga diaspora dhe se i njëjti nuk posedon asnjë votë.

Në mbështetje të pretendimeve të tij si provë ka bashkangjitur një kopje të fletëvotimit dhe një kopje të tabelës me të dhëna për kandidat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Shkelzen Spahiu, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilin ka pretenduar se sipas Rezultateve Përfundimtare të KQZ-së, ka mos përputhje të rezultatit të votave nga diaspora, i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara se nuk posedon asnjë votë, dhe si i tillë apeli është i pabazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është i bazuar në asnjë dëshmi të qartë dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.899/2021 më datën 07.11.2021**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.